



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 425/26, Datë 03.04.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 147 të mbajtur më 23.03.2026, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit Ekonomik – Universiteti i Prishtinës, për periudhën tri (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):

1. Marketing, BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.

II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

III. Obligohet Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

IV. Obligohet Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.

V. Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakultetit Ekonomik– Universiteti i Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Marketing, BSc 180 ECTS.	Fatos Ukaj Hykmete Bajrami Besim Beqaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Ekonomik – Universiteti i Prishtinës.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këto programe dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Marketing, BSc, (180 ECTS)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 05.12.2025.
Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush;
 - Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 147-të, të mbajtur më datë 23.03.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit Ekonomik – Universiteti i Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizites si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës.;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

2/2